



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Shk II.nr.259/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.T.SH “Auto Bokshi” me NUI 810005761 me seli ne Gjakovë, kundër debitorit N.SH “E-Vicotry” me NUI 810476912 me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1025/22 të datës 16.05.2023, me datë 07.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit N.T.SH “Auto Bokshi” me NUI 810005761 me seli ne Gjakovë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1025/22 të datës 16.05.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1025/22 të datës 16.05.2023 në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar prapësimin e debitorit “N.SH “E-Vicotry” me NUI 810476912 me seli në Prishtinë, ndërsa ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.254/2021, i datës 23.04.20221, i lejuar nga Përmbartuesi Gjokë Radi dhe ka përfunduar procedurën përmbartimore ne këtë çështje.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1025/22 të datës 16.05.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Ankesa e kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, mirëpo i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.T.SH “Auto Bokshi” me NUI 810005761 me seli ne Gjakovë, me datën 23.04.2021 ka paraqitur propozimin për përmbartim në bazë në bazë të dokumentit te besueshem - Faturë me nr: 263 dt.11.07.2028 per shumen e mjeteve ne lartësi

625.72 euro me të cilin është urdhëruar të gjitha bankat që operojnë në Republikën e Kosovës që ti sjellin transaksionet bankare për kreditorin ashtu që të bllokohen të gjitha llogaritë bankare të gjitha bankave dhe shuma e kërkuar së bashku me shpenzimet e përmbarimit dhe shuma e përcaktuar të barten nga llogaria e debitorit, duke llogaritur edhe kamatën ligjore prej ditës së dorëzimit të propozimit deri në pagesën definitive, shpenzimet procedurale të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri nën kërcënimin e pasojave ligjore.

Përmbaruesi Privat Gjokë Radi me seli në Gjaovë duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me urdhrin përmbarimor P.nr.254/2021, i datës 23.04.2021 e ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përmbarimor Debitori, ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor me arsyetim se borxhi i pretenduar, tashme është përmbushur duke i paguar mjetet në llogarinë bankare të kreditorit dhe se fatura e lëshuar e cila ka shërbyer si dokument përmbarues në të këtë çështje nuk e rregull, është e pavërtetë, nënshkrimi i konstatuar në të është i falsifikuar. Ka kërkuar të miratohet prapësimi i debitorit dhe urdhri përmbarimor të anulohet dhe refuzohet propozimi për përmbarim si dhe të obligohet kreditori që debitorit ti paguaj shpenzimet për përpilimin e prapësimit dhe të gjitha shpenzimet tjera, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit si të pabaza dhe ka theksuar se debitori gabimisht ka bere pagesën e faturës në bankën Proc Credit edhe pse në fature i është kërkuar që pagesën të e beje në bankën TEB, duke pas parasysh faktin se llogari në Procredit është e bllokuar dhe kjo i është bere me dije debitorit qysh me herët. Nga gjykata kërkoi ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim, me aktvendimin KPPP.nr.1025/22 të datës 16.05.2023 ka pranuar prapësimin e debitorit, ndërsa ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.254/2022, i datës 23.04.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Gjokë Radi me seli të zyrës në Gjakovë.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se dokumenti – faturat në bazë të cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin apo vulën e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta të jetë pranuar nga debitori, si dhe për faktin se në këtë çështje përmbarimor palët kanë prezantuar prova për përmbushjen e prestimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturës së lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore,

prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar ne ligj.

Gjykata e shkalles e dytë bazuar ne Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili ne nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh qe *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, konsideron se faturat e prezantuara ne këtë çështje si dokument përmbarimor ne sajë te cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se janë pranuar nga debitori, njëjtat nuk janë te vulosura, e as nënshkruara nga debitori, andaj në këtë mënyrë fatura nuk mund konsiderohet si dokument i besueshëm, e po ashtu nga shkresat e lendes nuk rezulton se palët kane prezantuar prova për ekzistimin e punës juridike, mbi bazën e se cilës do te derivonte fatura, si dokument i besueshëm

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K.Dh.Shk II.nr.259/24, me datë 07.06.2024,

Gjyqtari
Faton Bajrami